

**Liria dhe mbrojtja për Lezbiket,  
Homoseksualët, Biseksualët  
dhe Transgjinatorët në Kosovë**

**Sloboda i zaštita za lezbijke,  
homoseksualce, biseksualne  
i transrodne osobe na Kosovu**

**Freedom and Protection for  
Lesbians, Gays, Bisexuals  
and Transgender in Kosovo**



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS  
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

**CSGD**

---

# Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore


## Liria dhe mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjinatorët në Kosovë

Nëntor 2013



Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

---



**Botues:**

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë

**Redaktore:**

Raba Gjoshi

**Hulumtues:**

Besart Lumi  
Nazmi Gashi

**Asistent hulumtues:**

Liridon Zeka  
Granit Gashi

**Kontribuues:**

Arbër Nuhiu

**Dizanji & shtypi:**

Printing Press

**Tirazhi:**

500

© Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë  
[www.ks.yihr.org](http://www.ks.yihr.org)

---

## **Mirënjohjet**

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (NRDNJ KS) dëshiron të shpreh mirënjohjen e saj për të gjithë ata që kontribuuan në këtë hulumtim. Në veçanti, NRDNJ KS dëshiron të theksojë kontributin e Qendrës për Zhvillim të Grupeve Shoqërore për realizimin e intervistave me komunitetin LGBT dhe kontributin e z. Alban Gjonbalaj, znj. Lejla Sadiku dhe znj. Seyward Darby. Së fundi, NRDNJ KS falënderon Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë për mbështetjen financiare të dhënë në implementimin e këtij projekti.

## Përmbajtja

MIRËNJOHJET.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
II. HYRJE.....	7
III. METODOLOGJIA DHE DEMOGRAFIA THEMELORE.....	9
IV. KORNIZA LIGJORE.....	10
KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS.....	10
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR.....	11
PRAKTIKAT NGA SHTETET ANËTARE TË BE.....	14
V. TË JESH LGBT NË KOSOVË.....	16
TË JESH I HAPUR.....	16
FRIKA DHE DHUNA.....	18
VETËDIJESIMI DHE MBROJTJA.....	20
SFERA PUBLIKE.....	22
VI. ZBATIMI I LIGJIT.....	23
GJYQARËT DHE PROKURORËT.....	23
SHËRBIMI DHE MBROJTJA: POLICIA.....	25
INSTITUCIONET QEVERITARE.....	26
VII. KËRKIMI I NDIHMËS MJEKËSORE.....	28
QËNDRIMET NDAJ HIV-IT DHE KOMUNITETIT LGBT.....	30
VIII. PËRFUNDIM.....	32
IX. REKOMANDIMET.....	34

## I. Përmbledhje ekzekutive

Dalë nga një regjim socialist, çështja e të drejtave të minoriteteve seksuale ka qenë e neglizhuar në Kosovë. Edhe në periudhën pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, debati publik mbi të drejtat e lezbiqeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe personave transgjinnor si të drejta të njeriut, nuk ka ndodhur. Diskutimi mbi situatën e komunitetit LGBT dhe të drejtave të tyre po zhvillohet prapa dyerve të mbyllura, në mesin e një grupi të vogël të donatorëve mbështetës, organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, dhe informacione të rralla ndahen me publikun. Megjithatë, të jesh haptazi person LGBT në Kosovë është një luftë e përditshme për pranim, trajtim të barabartë, siguri personale dhe kundër paragjyqimeve të rrënjosura. Kjo ka çuar në krijimin e një komuniteti mbështetës të personave LGBT, por një që mbetet në margjinat e shoqërisë.

Korniza ligjore në Kosovë ofron garanci të gjera për të drejtat e njeriut, që rrjedhin si nga Kushtetuta ashtu edhe nga Ligji kundër diskriminimit, i cili është një nga legjislacionet më të përparuar kundër diskriminimit në regjion. Nëpërmjet Kushtetutës së saj, Kosova i jep superioritet juridik të drejtës ndërkombëtare dhe merr mbi vete zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Neni 22). Rrjedhimisht, aktgjykimet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë gjithashtu të vlefshme në Kosovë. Në legjislacionin vendor, përfshirja e orientimit seksual si bazë e mbrojtur në Ligjin kundër diskriminimit ishte një arritje e madhe.

Ky raport kombinon intervista gjysmë të strukturuar me anëtarët e komunitetit LGBT, pyetësorët e bartësve të detyrave dhe ofruesve të shërbimeve, me hulumtime. Ai kërkon për të dokumentuar situatën e komunitetit LGBT në Kosovë, të kuptojë aspektet kryesore të jetës, ku ata përballen me vështirësi dhe të vlerësojë vetëdijen dhe qasjen e zyrtarëve publikë dhe ofruesve të shërbimeve ndaj personave LGBT.

Ky hulumtim tregon se personat LGBT përballen me nivele të larta të abuzimit verbal, në përgjithësi jetojnë në frikë dhe gjendja e tyre është lënë pas dore nga mediat. Mbi 40 për qind të mostrës së përgjithshme të të anketuarve nga komuniteti LGBT tha se ata ishin abuzuar verbalisht në publik, dhe rreth 10 për qind ishin rrahur ose kërcënuar. Ndër të gjithë të anketuarit, pavarësisht nëse ata janë haptazi homoseksual apo jo, 50 për qind thonë se ata kanë frikë, për shkak të homofobisë së përhapur dhe rasteve të abuzimit. Pavarësisht këtyre kushteve, të anketuarit në mostrën tonë mendojnë se çështjes së tyre nuk i është dhënë vëmendje nga media.

Nga bartësit e detyrës, pyetësorët u shpërndanë tek gjyqtarët, prokurorët, avokatët, policët dhe zyrtarët e të drejtave të njeriut, si organe kryesore përgjegjëse për ruajtjen e sistemit juridik dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Gjykatësit dhe prokurorët janë përballur me një numër shumë të vogël të rasteve që përfshijnë çështjet LGBT. Ndonëse ekziston një trend i përgjithshëm i pranimit të drejtave të LGBT - për gjysmën e gjyqtarëve

të intervistuar ky është një koncept i cili Kosovës po i imponohet nga bashkësia ndërkombëtare. Në përgjithësi, pranimi dhe kuptimi i gjendjes dhe çështjeve të drejtave të komunitetit LGBT është më i lartë në mesin e oficerëve të policisë dhe zyrtarëve të drejtave të njeriut, megjithatë kjo nuk është në një nivel të dëshirueshëm.

Në profesionin mjekësor, si në të tjerët, rezultatet janë të përziera. Edhe pse kryesisht profesionistët mjekësorë thonë se ata besojnë se të gjithë pacientëve, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, duhet t'iu jepet trajtim i barabartë, paragjykimet dalin në sipërfaqe gjatë pyetjeve tjera. Profesionistët mjekësorë ishin më të hapur për pranimin e rasteve nga komuniteti LGBT – rreth 90 % e kishin të lehtë këtë. Megjithatë, kjo gjoja tolerancë është në kontrast me një nivel të lartë të paragjyqimit ku një në katër profesionistë mjekësorë pretendojnë të jenë në gjendje për të përcaktuar nëse një person është LGBT bazuar në sjelljen apo dukjen e tyre.

Duhet të theksohet se profesionistët nëpër fusha të ndryshme ishin ngurrues për të plotësuar pyetësorët. Kjo ishte veçanërisht e përhapur në mesin e profesionistëve mjekësor dhe avokatëve. Në raste të tjera, zyrtarët refuzuan t'iu përgjigjen pyetjeve të ndjeshme dhe në disa raste ata e kanë plotësuar pyetësorin për të pasqyruar një nivel të tolerancës, megjithatë verbalisht e kanë shprehur të kundërtën. Prandaj, në vetë procesin e hulumtimit, përplasja në mes të qëndrimeve të pritshme dhe normave ekzistuese shoqërore u bë e qartë: bartësit e detyrave dhe ofruesit e shërbimeve kanë qenë të vetëdijshëm për atë që çka ata duhet të thonë për qëllimet e studimit, pavarësisht se mbajnë pikëpamje të kundërta. Përveç kësaj, vështirësia e pranimit të zyrtarëve për të marrë pjesë në studim e forcon argumentin se ka një ngurrim për të adresuar çështjet e LGBT.

Të gjeturat e përgjithshme të hulumtimit sugjerojnë se ekziston një nivel i ulët i vetëdijes për çështje të veçanta që kanë të bëjnë me komunitetin LGBT. Për më tepër, pavarësisht mbizotërimit të lartë të abuzimit, shumë pak prej abuzimeve të treguara janë raportuar tek autoritetet përkatëse dhe jo të gjitha janë përcjellë. Për këtë qëllim, rekomandimet thërrasin për një rol më pro aktiv të shtetit në promovimin e trajtimit të barabartë dhe ngritjen e vetëdijes në mesin e zyrtarëve publik mbi përgjegjësinë e tyre për të zbatuar legjislacionin në fuqi në Kosovë.

## II. Hyrje

Sulmet dhe abuzimi ndaj personave LGBT, ose personave që janë perceptuar të jenë LGBT, nuk janë të rralla në Kosovë – dhe për këtë flasin të dyja tregimet e mbledhura gjatë rrjedhës së këtij hulumtimi dhe incidentet që kanë qenë të raportuara në media. Më 9 shtator 2013, filloi një proces gjyqësor për shkak të sulmeve që ndodhën në dhjetor 2012 kundër publikimit të numrit të revistës Kosova2.0 mbi “SEX” - in, që u interpretua nga disa grupe ekstremiste si një ngjarje mbështetëse për LGBT. Disa natë më vonë, zyrat e Libertas, një OJQ e cila punon me komunitetin LGBT, u sulmuan gjithashtu. Edhe pse revista merrej me një gamë të gjerë çështjesh që përfshijnë seksin dhe më pak vëmendje i është dhënë sulmit ndaj Libertas, këto incidente ndihmuan për të ndezur debatin mbi situatën e komunitetit LGBT, si pjesë më pak e shërbyer e shoqërisë. Diskutimi publik që pasoi shënoi fillimin e një rrugë të jashtëzakonshme që Kosova duhet të ndjekë në mënyrë që të arrihen zhvillimet e nevojshme shoqërore dhe ligjore, të cilat do të lejojnë të gjithë qytetarët e Kosovës të marrin pjesë në jetën publike me sigurimin e të drejtave civile të tyre. Për fat të keq, sulmet në dhjetor janë vetëm një pjesë e vogël e një mozaiku më të madh të kërcënimeve, abuzimit fizik dhe verbal i cili në bazë ditore ndikon mbi anëtarët e komunitetit LGBT dhe të cilat mbeten larg vëmendjes së medias.

Çështja e të drejtave të minoriteteve seksuale ka pasur vëmendje të kufizuar nga shteti, shoqëria civile dhe sektorët e medias, si dhe komunitetit të donatorëve, pjesërisht për shkak të sfidave politike dhe socio - ekonomike të Kosovës, që janë perceptuar të jenë me prioritet më të lartë. Që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999, arritja më e madhe në këtë zonë ishte përfshirja e pakicave seksuale në klauzolën e kundër - diskriminimit në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, megjithatë, kjo nuk ka rezultuar domosdoshmërisht në përmirësimin e situatës në terren. Komuniteti i lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinatorëve (LGBT) funksionon brenda një rrjeti të organizuar dhe të fshehtë të individëve dhe disa organizatave. Sektori i OJQ-ve me bazë në këtë çështje gjithashtu shërbejnë si organizata për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për një grup të gjerë çështjesh – nisur nga pranimi e deri te ajo se si përballen me abuzimin.

Në jetën publike të Kosovës nuk ka shenja të dukshme të komunitetit LGBT dhe me siguri nuk ka bare apo klube të homoseksualëve. Konventat sociale dhe mundësitë e kufizuara socio - ekonomike diktojnë që shumica e të rinjve në Kosovë jetojnë me familjet e tyre derisa ata të martohen; “dalja” si një person LGBT mund të shoqërohet me humbjen e mbështetjes familjare dhe ka pasur edhe raste kur anëtarët ishin përjashtuar nga shtëpitë familjare të tyre<sup>1</sup>. Për më tepër, pasi që lidhjet familjare mbeten të fuqishme, bëhet një presion i palejueshëm për martesë. Megjithatë, komuniteti LGBT në Kosovë është i gjallë dhe kohët e fundit një numër i vogël i individëve LGBT kanë pasur guxim të thyejnë heshtjen dhe të flasin hapur.

<sup>1</sup> Fauchier, Agathe. “Kosovo: what does the future hold for LGBT people?”. Forced Migration. Refugee Studies Centre. Oxford University.



---

Përderisa homoseksualët dhe lezbiket ngadalë janë duke punuar drejt fitimit të një dukshmërie dhe njohje shoqërore më të madhe, kjo është akoma larg për nëngrupin e transjinatorëve<sup>2</sup>.

Ky raport ka për qëllim të dokumentojë ambientin në të cilin komuniteti LGBT jeton dhe punon, dhe shtrirjen e mbrojtjes dhe mbështetjes që ata mund të gjejnë nga institucionet shtetërore dhe në shërbimet publike. Raporti synon të mbushë një zbrazëtire informative në lidhje me vështirësitë me të cilat përballet ky komunitet dhe dokumenton fushat ku mbrojtja e të drejtave themelore duhet fuqizuar. Raporti bazohet në hulumtimet e mëparshme të kufizuara të kryera mbi këtë temë, si edhe në intervista kualitative dhe kuantitative dhe pyetësorë të plotësuar nga anëtarët e komunitetit LGBT në Kosovë, si dhe nga ekspertë dhe profesionistë, të identifikuar si profesionistë tek të cilët anëtarët e komunitetit LGBT do të adresojnë çështjet e tyre. Kështu, intervista gjysmë të strukturuar janë kryer me pjesëtarët e komunitetit LGBT, policë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesionistë mjekësorë dhe zyrtarë të drejtave të njeriut.

Ky raport fillon me metodologjinë e përdorur për hulumtimin e raportit. Më tej, ai vazhdon me një pasqyrë të kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të krahasuar me situatën në regjion dhe Evropë. Të dhënat që dalin nga hulumtimi janë ndarë për të gjetur modele përgjatë të gjitha grupeve të synuara të intervistuarve. Raporti përfundon me një numër rekomandimesh të bazuara në këtë hulumtim, si dhe sugjerime nga të anketuarit.

---

<sup>2</sup> Ibid.

### III. Metodologjia dhe demografia themelore

Ky raport është i bazuar në hulumtimet primare dhe dytësore, të përbërë nga intervista gjysmë të strukturuar në tërë Kosovën (shih Figurën 2) dhe shqyrtimin e hulumtimeve ekzistuese. Analiza sasiore është e bazuar në intervista gjysmë të strukturuar me synim personat LGBT, bartësit e detyrave dhe ofruesit e shërbimeve, me numër prej 308 (treqind e tetë) pyetësorë. Për këtë qëllim, 88 (tetëdhjetë e tetë) pyetësorë u janë shpërndanë anëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë, 17 (shtatëmbëdhjetë) pyetësorë gjyqtarëve, 8 (tetë) prokurorëve, 17 (shtatëmbëdhjetë) avokatëve, 30 (tridhjetë) oficerëve të policisë, 59 (pesëdhjetë e nëntë) zyrtarëve për të drejtat e njeriut në institucionet e nivelit qendror dhe lokal, dhe 89 (tetëdhjetë e nëntë) profesionistëve mjekësorë. Në përgjithësi, ky hulumtim është një pasqyrë gjithëpërfshirëse e perceptimeve të përhapura në Kosovë që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve dhe mbrojtjes të ofruara këtij komuniteti. Ai siguron njohuri të besueshme dhe unike mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin LGBT, duke ofruar një bazë të shëndoshë për intervenimet e ardhshme të qeverisë dhe shoqërisë civile.




Figura 1 Demografia e moshës së të intervistuarve




Figura 2 Shpërndarja e pyetësorëve nëpër komuna

Rreth 45 për qind e pyetësorëve u janë shpërndarë njerëzve në mes të 18-35 vjeç dhe pjesa tjetër për moshën mbi 36 vjeç. Shpërndarja e tillë reflekton objektivin e hulumtimit që ishte profesionistët e njohur që punojnë në fushën e tyre. Të intervistuarit nuk u pyetën për gjininë e tyre, përveç personave LGBT, ku rreth 25 % e personave të anketuar ishin femra. Sa i përket grupeve etnike dhe fetare, 97 % e të intervistuarve deklaruan veten si shqiptar dhe mbi 88 % kanë identifikuar vetën si pjesëtarë të bashkësisë myslimane, 3.6 për qind janë deklaruar si katolikë, 4 për qind si jo fetar, 1.3 për qind si ateistë, 1 për qind ortodoksë dhe 1 për qind protestantë. Përbërja etnike dhe fetare e mostrës është përfaqësuese e demografisë për Kosovën<sup>3</sup>. Nga popullata mostër, 20 për qind kanë deklaruar se e praktikojnë fenë rregullisht dhe 38 për qind që e praktikojnë ndonjëherë. 28 për qind e popullatës së mostrës fare nuk e praktikon fenë.

<sup>3</sup> Regjistrimi në Kosovë 2011.

## IV. Korniza ligjore

### Korniza Ligjore e Kosovës

Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve seksuale është një e drejtë themelore që rrjedh nga korniza ligjore në Kosovë dhe nga obligimet dhe traktatet ndërkombëtare, të cilat Kosova ka marrë përsipër. Brenda vendit, Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji kundër diskriminimit janë dy shtyllat kryesore që ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi për komunitetin LGBT. Pasi që Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, ajo nuk është nënshkruese e traktateve ndërkombëtare. Megjithatë, neni 19 i Kushtetutës, i jep superioritet marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe normave juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare mbi ligjin e Republikës së Kosovës, dhe neni 22, i cili ka të bëjë me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollat e saj<sup>4</sup>.

Ligji Kundër Diskriminimit është legjislacioni themelor për çdo shoqëri që kërkon të jetë e bazuar mbi parimet e trajtimit të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Ligji i Kosovës bazohet në tri parime themelore duke përfshirë parimin e trajtimit të barabartë, përfaqësimit të barabartë dhe tolerancës midis njerëzve<sup>5</sup>. Ligji është në fuqi që nga shtatori i vitit 2004 (Ligji Nr.2004 / 3), Neni 2 (a) i të cilit përshkruan si një prej parimeve të tij ndalimin e diskriminimit mbi 16 baza, përfshirë edhe orientimin seksual. Ligji Kundër Diskriminimit zbatohet në një gamë të gjerë të drejtave dhe formave të pjesëmarrjes në jetën publike - duke përfshirë punësimin dhe avancimin në punë, qasjen në aftësim profesional, anëtarësimin në organizata, mbrojtjen sociale dhe avantazhet sociale, arsimim, qasjen në banim, qasjen në pronë, trajtimin e drejtë para Gjykatave, sigurinë personale, pjesëmarrjen në çështjet publike, qasjen në vendet publike. Ligji është i ndërtuar mbi dy direktivat kryesore evropiane, Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e qershorit të vitit 2000, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht racës apo origjinës etnike, dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC e nëntorit të vitit 2000, e cila përcakton kornizën e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim, ndalon diskriminimin e bazuar në fe, aftësi të kufizuar, moshë apo orientim seksual<sup>6</sup>. Institucioni i Avokatit të Popullit është përcaktuar si një organ i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave lidhur me shkeljet e të drejtave të bazuara në diskriminim.

Edhe pse shoqëria kosovare mbetet kryesisht tradicionale dhe konservatore, Kosova është vetëm një nga dhjetë vendet që ka ndaluar diskriminimin në bazë të orientimit seksual në kushtetutën e vet<sup>7</sup>.

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

<sup>5</sup> "Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit: Sfidë për Kosovën." OSBE. Qershor 2007

<sup>6</sup> "Zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit: Ligji nr. 2004/32". YIHR. Janar 2007

<sup>7</sup> Fauchier, Agathe. "Kosovo: what does the future hold for LGBT people?". Forced Migration. Refugee Studies Centre. Oxford University.

Kushtetuta e Kosovës, e cila është hartuar nëpërmjet një procesi pjesëmarrës në vitin 2007, fuqishëm ndjek parimet e mishëruara në kushtetutat e Evropës Perëndimore, veçanërisht të Gjermanisë dhe Francës. Kushtetuta e Kosovës është parë si një që përkrah standardet më të larta ndërkombëtare dhe evropiane të drejtave të njeriut dhe prandaj përfshin shprehjen “orientim seksual” në nenin kundër diskriminimit (neni 24). Për më tepër, neni mbi përkufizimin e martesës është hartuar në mënyrë liberale dhe nuk bën ndonjë referim të veçantë ndaj gjinisë. Megjithatë, ai i referohet Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr. 2004/32), ku martesa është e përcaktuar të jetë ndërmjet një mashkulli dhe femre.

Në sistemin gjyqësor të paraparë nga Kushtetuta e Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është çelësi për shkak të zbatimit të saj të drejtpërdrejtë që buron nga neni 22, por edhe sepse në bazë të nenit 53 “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ)”<sup>8</sup>. Prandaj vendimet kryesore në respektimin e të drejtave për çiftet e të njëjtës gjini dhe ndalimin e fjalorit të urrejtjes, të tilla si rastet Ladele dhe McFarlane kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. i aplikimit 51671/10 dhe 36516/10) dhe Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë (aplikimi nr. 1813-1807) janë të aplikueshme në Kosovë. Znj. Ladele dhe znj. MacFarlane ishin larguar nga puna, pasi ato kishin refuzuar për të zyrtarizuar partneritetin civil dhe t’i ofrojnë këshillim një çifti të së njëjtës gjini, duke u thirrur në besimin e tyre fetar<sup>9</sup>. Gjykata gjeti se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës për të praktikuar lirisht fenë. Në fakt, vendimet mishërojnë normën se bindjet personale nuk mund të shërbejnë si një justifikim për diskriminim të personave në ofrimin e shërbimeve në bazë të orientimit seksual. Në rastin e Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë, gjykata vendosi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të lirisë së shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dënimin e aplikuesve për shkak të shpërndarjes së fletushkave që u konsideruan ofenduese për homoseksualët<sup>10</sup>, një vendim i rëndësishëm pasi që për herë të parë u trajtua gjuha e urrejtjes ndaj personave homoseksualë.

Për dallim nga homoseksualët dhe lezbiket, personat transgjinator nuk njihen nga Kushtetuta dhe pavarësisht se nuk ka ligje që në mënyrë aktive kriminalizojnë sjelljen transgjimore, kjo nuk mund të konsiderohet për të kuptuar se të drejtat e personave transgjinator janë të mbrojtura. Në shumë vende të BE-së, diskriminimi në trajnim dhe punësim për shkak të ndërrimit të gjinisë është konsideruar të jetë një formë e diskriminimit gjinor<sup>11</sup>.

<sup>8</sup> Guy Van Craen dhe Emilio Gatti. “Reasonable time.” European Rights.

URL: [www.europeanrights.eu/public/.../secondo\\_commento\\_gatti\\_testo.do](http://www.europeanrights.eu/public/.../secondo_commento_gatti_testo.do)

<sup>9</sup> Vendimi i plotë i GJEDNJ: <http://hudoc.echr.coe.int/webservices/content/pdf/001-115881>

<sup>10</sup> Vendimi i plotë i GJEDNJ:

<http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx#%7B%22dmdocnumber%22%3A%5B%22900340%22%5D%2C%22display%22%3A%5B0%5D%7D>

<sup>11</sup> European Agency for Fundamental Rights. “Legal Study on Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation – United Kingdom.” 2008

## Vështrim i përgjithshëm i situatës në Ballkanin Perëndimor

Në të gjithë regjionin e Ballkanit Perëndimor, komuniteti LGBT përballet me një ambient të fuqishëm ligjor dhe shoqëror, duke luftuar kundër normave të ngulitura shoqërore dhe duke u konfrontuar me keqtrajtimin në hapësirën publike. Diskriminimi është i përhapur në të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor dhe në përgjithësi ka një ndërgjegjësim të ulët publik mbi mbizotërimin e diskriminimit në këto shoqëri.

Në rastin e **Shqipërisë**, homoseksualiteti është de-kriminalizuar në vitin 1995, por toleranca ndaj popullatës LGBT mungon. Ish- Kryeministri shqiptar, z. Sali Berisha, në fillim të 2009 deklarohet të jetë në favor të martesave të së njëjtës gjini<sup>12</sup>. Deklaratat e tij u pasuan më vonë me miratimin e Ligjit kundër diskriminimit në shkurt të vitit 2010, i cili ndalon diskriminimin (në mes tjerash) sipas orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe themelon Komisionarin për Mbrojtjen kundër Diskriminimit<sup>13</sup>. Deklaratat homofobike të bëra nga dy politikanë në vitin 2011 janë duke u hetuar nga ana e Komisionarit<sup>14</sup>. Në Raportin e të BE-së mbi Progresin, u vë në dukje se përderisa ekzistojnë disa ligje, autoritetet duhet të zbatojnë legjislacionin ekzistues<sup>15</sup>. Për më tepër, raporti vlerësoi pozitivisht ndryshimin në Kodin Penal për të marrë parasysh rrethanat rënduese për veprat penale që lidhen me identitetin gjinor dhe orientimin seksual, në se tjerash.

Ligji Kundër Diskriminimit në **Bosnje dhe Hercegovinë** u miratua në gusht të vitit 2009, dhe organi i autorizuar për monitorimin e zbatimit të ligjit është Zyra e Avokatit të Popullit<sup>16</sup>. Së fundmi, Dhoma e Përfaqësuesve miratoi legjislacionin për krimet e urrejtjes që nuk përfshin identitetin gjinor dhe orientimin seksual<sup>17</sup>. Megjithatë, ndryshimet dështuan për shkak të mungesës së mbështetjes në Dhomën e Përfaqësuesve të Federatës, prandaj gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes vazhdojnë të mbeten shqetësim<sup>18</sup>. Një hap pozitiv ishte gatishmëria e organeve të zbatimit të ligjit në kantonin e Sarajevës të emërojnë një kontakt të drejtpërdrejtë në çdo stacion policor për personat LGBT<sup>19</sup>.

Në vitin 2012, Komisioni Evropian konstatoi se legjislacioni kundër diskriminimit i **Maqedonisë** nuk ishte në përputhje me *acquis*, pasi që diskriminimi në baza të orientimit seksual nuk ishte përfshirë. Në vitin 2013, situata është përkeqësuar pas raportimit të sulmeve të dhunshme kundër Qendrës së Mbështetjes për LGBT në Shkup<sup>20</sup>.

<sup>12</sup> "Berisha: Legalizim Martesave Gay". Koha Jonë. <http://www.kohajone.com/artikull.php?idm=45138>

<sup>13</sup> Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.

[http://www.asp.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=213%3Aligj-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi&catid=61%3Aligje-e-vendime&Itemid=170&lang=sq](http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=213%3Aligj-per-mbrojtjen-nga-diskriminimi&catid=61%3Aligje-e-vendime&Itemid=170&lang=sq)

<sup>14</sup> Të drejtat e njeriut në Shqipëri. Civil Rights Defenders. Tetor 2012.

<http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>

<sup>15</sup> "Raporti i Progresit i Shqipërisë 2013." Komisioni Evropian.

<sup>16</sup> Të drejtat e njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë. Civil Rights Defenders. Tetor 2012.

<sup>17</sup> "Bosnia adopts trans-inclusive hate crime law." Trans Gender Europe. July 27, 2013.

<sup>18</sup> "Raporti i Progresit i Bosnjës dhe Hercegovinës 2013." Komisioni Evropian.

<sup>19</sup> Ibid.

<sup>20</sup> "Maqedoni: Furi e sulmeve kundër homoseksualëve." Human Rights Watch. Korrik 2013.

Për më tepër, përmbajtja homofobike në media vazhdon dhe autoritetet kanë ndërmarrë veprime të kufizuara në trajtimin e diskriminimit kundër komunitetit LGBT. Boris Dittrich, drejtor i avokimit për të drejtat e LGBT, ka akuzuar Qeverinë Maqedonase për mbylljen e syve ndaj huliganëve anti – homoseksual, pasi që asnjë zyrtar i qeverisë nuk ka folur publikisht kundër sulmeve flagrante<sup>21</sup>.

Kohët e fundit në **Malin e Zi** janë në rritje diskutimet rreth diskriminimit kundër personave LGBT. Mbizotërimi i homofobisë është pasojë e normave shoqërore, mungesës së njohurive, dhe kornizës jo adekuate ligjore dhe institucionale, të kombinuar me burime të kufizuara<sup>22</sup>. Në vitin 2012, Avokati i Popullit paraqiti një nismë Kuvendit për miratimin e Ligjit mbi bashkësinë e partnerëve të njëjtës gjini, por nuk është reale të pritët që ligji do të miratohet në të ardhmen e afërt<sup>23</sup>. Një hap pozitiv ka qenë miratimi i strategjisë së qeverisë për rritjen e cilësisë së jetës së personave lezbike, homoseksual, biseksual, transgjiiinor dhe inter-gjinor për 2013-2018. Për më tepër, për herë të parë Parada e Krenarisë u zhvillua në Budva në korrik 2013 dhe u mbështet nga autoritetet, megjithatë ka pasur sulme ndaj pjesëmarrësve<sup>24</sup>. Parada e dytë e Krenarisë u mbajt në Podgoricë më 20 tetor 2013 nën mbrojtjen e madhe të policisë, por e cila megjithatë rezultoi me dhunë nga huliganët që protestonin kundër ngjarjes dhe evakuimin e pjesëmarrësve në paradë<sup>25</sup>.

Në **Serbi**, me gjithë ndalimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual të përmbajtur në disa ligje dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të dhjetorit 2011, se ndalimi i Paradës së Krenarisë në vitin 2009 ishte jo kushtetues, perceptimi i përgjithshëm në mesin e personave LGBT është se sistemi gjyqësor nuk mund të sigurojë mbrojtje adekuate. Këtë vit, Qeveria e Serbisë ndaloi për të tretin vit radhazi Paradën e Krenarisë në Beograd, me gjithë kundërshtimin e zëshëm nga organizatat ndërkombëtare<sup>26 27</sup>. Legjislacioni kundër diskriminimit në përgjithësi është në përputhje me standardet evropiane dhe strategjia gjithëpërfshirëse kundër diskriminimit 2013-2018 u miratua në qershor, e cila gjithashtu synon personat LGBTI. Për më tepër, ka pasur një trajtim më aktiv të rasteve të diskriminimit kundër popullatës LGBT<sup>28</sup>. Gjykata e Apelit në Novi Sad ka marrë një aktgjykim historik dhe ka vendosur një precedent juridik në Serbi pas gjobitjes së një personi për diskriminim kundër kolegut të tij të punës në bazë të orientimit seksual të këtij të fundit<sup>29</sup>.

21 Ibid.

22 "Raporti mbi zbatimin e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)5 mbi masat për luftimin e diskriminimit në baza të orientimit seksual ose identitetit gjinor." JUVENTAS. Podgoricë, 2012.

23 Raporti për të drejtat e njeriut në Malin e Zi. Civil Rights Defenders. 2012

24 Raporti i Progresit për Malin e Zi 2013." Komisioni Evropian.

25 Parada u Podgoricë održana uz ogromno obezbeđenje i nemire. Tanjug. October 20, 2013. Tanjug.rs

26 Serbia: UN rights office urges protection of gay rights after pride parade is cancelled. United Nations. October 1, 2013.

27 Raporti për shtetin: Serbia. Civil Rights Defenders. 2012

28 Raporti i Progresit për Serbinë 2013." Komisioni Evropian.

29 Barlovac, Bojana. "Serbia Court Delivers Landmark Verdict." Balkan Insight. January 10, 2013.

Duke pasur parasysh gatishmërinë e vendeve të Ballkanit për të hyrë në BE, në fushën e të drejtave të njeriut, BE-ja ka përdorur qasje të karotës dhe shkopit. Krahasuar me pranimin e vitit 2004 dhe 2007, BE-ja ka rritur presionin mbi vendet candidate për të ndjekur dhe të mbrojtur parimet e të drejtave të njeriut<sup>30</sup>. Përderisa ka pasur disa ndryshime ligjore, rruga përpara është e gjatë dhe e stuhishme.

### Praktikat nga Shtetet Anëtare të BE




Figura 3 Harta e botës, që tregon ligjshmërinë e martesës së të njëjtës gjini dhe ashpërsinë e dënimeve (Burimi: Max Fisher/ Washington Post)

Harta e mësipërme jep një përshkrim të situatës për pakicat seksuale në mbarë botën. Zonat me të kaltër të mbylltë tregojnë pjesët e botës ku martesa e të njëjtës gjini është e ligjshme ndërsa e kaltër e hapur tregon ku bashkësitë e të njëjtës gjini janë ligjore. Janë vetëm disa vende në botë ku martesa me gjini të njëjtë është e mundur, në Bashkimin Evropian vetëm në Britani të Madhe, Spanjë dhe Holandë çiftet e të njëjtës gjini mund të martohen ligjrisht, megjithatë bashkësia civile është më gjerësisht e pranishme si një formë e legalizimit të marrëdhënieve.

Hapat fillestar për shfaqjen e angazhimit të BE-së për të promovuar të drejtat e njeriut ishte përfshirja e Nenit 19 në Traktatin e Amsterdimit të vitit 1997, i cili ka autorizuar BE-në të “marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual.”<sup>31</sup> Në vitin 2000, kjo solli Direktivën e Këshillit 2000/78/EC e cila siguron trajtim të barabartë për të gjithë në vendin e punës, duke ndaluar diskriminimin në punësim në një numër të bazave përfshirë edhe orientimin seksual.

<sup>30</sup> Kochenov, Dmitry.2006. “Democracy and Human Rights Not for Gay People: EU Eastern Enlargement and Its Impact on the Protection of the Rights of Sexual Minorities.”

<sup>31</sup> Traktati i Amsterdimit. 1997. <http://www.eurotreaties.com/amsterdamtreaty.pdf>

---

Duke marrë parasysh numrin e vendeve të prekura, duke numëruar edhe vendet të cilat dëshirojnë të hyjnë në BE, kjo direktivë është ndoshta një nga nismat më të rëndësishme legislative në historinë e të drejtave të LGBT<sup>32</sup>.

Përveç kësaj, të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë të detyruar të krijojnë organet kombëtare të barazisë, të cilat janë organe të pavarura që synojnë të nxisin trajtimin e barabartë, hulumtojnë diskriminimin, si dhe të ofrojë shërbime këshilluese për viktimat. Këto organe janë të detyrueshme në fushën e diskriminimit racor dhe gjinor sipas të drejtës së BE-së, por jo në atë të orientimit seksual. Në Rrjetin Evropian të Organeve të Barazisë aktualisht ka 38 trupa që vijnë nga 31 vende të ndryshme, nga të cilat 30 anëtarë kanë një mandat në raport me personat lezbike, homoseksual, biseksualë, trans dhe inter gjinor në punësim dhe 22 në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve<sup>33</sup>. Suedia ka një organizatë specifike avokuese (HomO) që merret me diskriminim në bazë të orientimit seksual dhe që ka treguar veten të jetë shumë e suksesshme në fitimin e besimit të viktimave të homofobisë<sup>34</sup>.

---

<sup>32</sup> European Union and LGBT Rights. ILGA Europe.

<sup>33</sup> "Equality bodies promoting equality and non-discrimination for LGBTI people." EQUINET. 2013

<sup>34</sup> European Agency for Fundamental Rights. "How EU Law Offers Protection from Sexual Orientation Discrimination." 2009



## V. Të jesh LGBT në Kosovë

Komuniteti LGBT në Kosovë në përgjithësi ndihet i kërcënuar dhe i frikësuar; mbështetja kryesore vjen nga miqtë e tyre të ngushtë dhe personat tjerë LGBT. Grupi i intervistuar kishte demografi të përzier, me një fokus të veçantë në të rinjtë, ku 62 për qind e të anketuarve ishin 18-26 vjeç, 23 për qind ishin në mes të moshës 27-35, dhe 15 për qind ishin në grupin demografik të moshës 36-49. Për 90% të mostrës, arritja më e lartë e tyre arsimore është arsimi i mesëm (67%) ose fillor (23%), dhe 25 për qind e të anketuarve thanë se ata ishin ende studentë. Për sa i përket punësimit, vetëm 28 për qind kanë raportuar të jenë të punësuar, prej të cilëve më së shumti në sektorin privat ose të shoqërisë civile, e cila është më e ulët se norma mesatare e punësimit kombëtar edhe për të rinjtë.

Prej 88 anëtarëve të intervistuar të LGBT, 61 për qind ishin homoseksual ose lezbike, 25 për qind biseksual dhe 14 për qind transgjinatorë. Pothuajse një në katër (23%) e të anketuarve janë të martuar ose në një marrëdhënie heteroseksuale. Mbi 80% e të anketuarve kanë deklaruar se ata janë ose nganjëherë janë të hapur për orientimin e tyre seksual ose kurrë, dhe vetëm 1 i anketuar tha se ajo/ai ishte haptazi homoseksual.

### Të jesh i hapur

Në kontekstin e Kosovës, të qenit i hapur nuk do të thotë të jesh haptazi homoseksual. Në vend të kësaj, kjo është kryesisht një proces i hapjes së personave LGBT për orientimin e tyre seksual me njerëzit nga të cilët presin se do të kenë një përgjigje pozitive. Prandaj, sipas të dhënave, në këtë proces të mirëkuptimit, pranimit, dhe vlerësimit të identitetit seksual të dikujt, shumë të anketuar duket të jenë pranuar me krahë të hapur. "Miq të e mi më pranuan - më thanë se është jeta ime dhe se duhet ta jetoj si unë të dua. Vëllai im, po ashtu: ai më tha se ne ishim vëllezër dhe se nuk kishte rëndësi nëse isha homoseksual, ai më respekton njësoj", pohon një i anketuar. Megjithatë, këto tregime paraqesin një pamje të shtrembëruar mbi situatën e personave LGBT, pasi që më së shumti kemi të bëjmë me një grup të ngushtë të personave të besueshëm dhe/ose anëtarëve të familjes të cilët ka të ngjarë të jenë më të hapur dhe tolerant. "Gjithkush ka reaguar mirë, sepse u kam thënë njerëzve të duhur në kohën e duhur", pranon një i intervistuar, dhe një tjetër shton "Unë i njihja mirë ata dhe isha i vetëdijshëm se ata do të jenë të hapur ndaj personave LGBT." Pjesa mbizotëruese e të anketuarve janë "të hapur" ndaj miqve të tyre (33%), në krahasim me 16% që janë hapur ndaj prindërve të tyre dhe 20% për vëllezërit e motrat. Megjithatë, këto qëndrime pozitive nuk mund të merren si një pikë referimi për pranimin shoqëror të personave LGBT. Ka më shumë të ngjarë që arsyet janë të lidhura me faktin që anëtarët zgjedhin njerëzit nga të cilët ata presin që të jenë mbështetës. Brenda mjedisit të tyre të ngushtë, ata ishin kryesisht (60%) të inkurajuar që të jetojnë jetën e tyre dhe se anëtarët e ngushtë të familjes apo miqtë do të japin mbështetjen e nevojshme për të përballuar sfidat e të qenit LGBT sot në Kosovë. Sidoqoftë, kjo nuk

është rregull, pasi rreth 15 % e të anketuarve raportojnë se kanë qenë të izoluar nga familja e tyre ose miqtë. Sinqeriteti në lidhje me orientimin seksual u ka kushtuar atyre miqësi dhe është pasuar me sulme verbale dhe fizike nga anëtarët e familjes. Një i anketuar thotë, “në familje reagimi ishte negativ, ata bërtitën dhe madje më sulmuan fizikisht, megjithatë tani gjërat janë qetësuar dhe ne thjesht nuk flasim rreth kësaj.” Mekanizmat e përballimit ndryshojnë - ka raste që pas një periudhe të caktuar disi vjen deri te pranimi i situatës në heshtje, por në raste të tjera lidhjet familjare janë këputur. “Vëllai dhe motra ime reagues keq ... ata më thanë se kjo nuk ishte normale, kjo ishte një sëmundje, që unë duhet të ndryshohem, por me kalimin e kohës kuptuan se unë nuk mund ta bëjë këtë dhe në një mënyrë[situata u bë] më e qetë”, por të anketuarit e tjerë kanë qenë me më pak fat. “Të gjithë të cilëve ju tregova se isha homoseksual kanë reagues keq. Familja ime nuk më ka pranuar dhe më përjashtoi nga shtëpia familjare. Të tjerët më thanë se isha i sëmurë, por pas një kohe më pranuan, jo sepse ata mendojnë se kjo është një gjë e mirë, por për shkak se ata më respektojnë”, ndan një i anketuar. Gjatë hulumtimit me komunitetin LGBT, u paraqitën shumë tregime të vështirësive por edhe të kurajës, të gjithë prej të cilëve nuk mund t'i jepet vëmendja që meritojnë në kuadër të këtij raporti.




Figura 4 Shumica e të anketuarve janë pritur me reagime pozitive në procesin e “hapjes”

Hapja ndaj anëtarëve të familjes vazhdon të jetë një sfidë serioze në kërkimin për të shprehur lirisht identitetin në Kosovë për një anëtar të një minoriteti seksual – rreth 52 për qind e të anketuarve janë të frikësuar për të folur me familjet e tyre në lidhje me orientimin e tyre seksual. Të jesh homoseksual nuk është e lidhur vetëm me kërcënimin fizik në shoqëri, por shumë shpesh edhe me mungesën e të kuptuarit dhe të përballurit me abuzimin në familje. Nga të anketuarit e përgjithshëm, 13% kanë raportuar se janë përballur me nofka dhe kanë rrezikuar izolimin nga familja. Një person homoseksual thekson, “Në vitin 2007 unë u përjashtova nga shtëpia e familjes, pasi i thashë familjes time se isha homoseksual. Unë nuk munda të gënjejë më. E dija se kjo do të jetë e

vështirë, por kam menduar se ata do të më pranojnë pasi që unë isha djali i vetëm ... babai filloi të më ofendojë dhe ... pas tri ditësh u përzura nga shtëpia e familjes, pasi që sipas tyre unë e kisha turpëruar familjen. Për tre vjet kam qëndruar në shtëpi dhe qytete të ndryshme. U përpoqa të shkojë në shtëpi disa herë, por u refuzova. Së fundi, ata më ftuan të kthehesha, por ne kurrë nuk flasim për këtë temë.” Pasi që familjet mbeten ngushtë të lidhura dhe të rinjtë vazhdojnë të përballen me pengesa socio -ekonomike në gjetjen e punësimit, ata mbesin të varur nga mbështetja e familjeve të tyre. Vlerat kulturore tradicionale janë nganjëherë të lidhura edhe me fenë, duke e zmadhuar frikën e mospranimit të mëtejshëm. Gjatë intervistave fjala frikë dominon - frika e humbjes së familjes, frika e mos-pranimit, dhe frika e mos pasurit kujt t'i drejtohesh.

## Frika dhe dhuna

Pavarësisht reagimeve mbizotëruese pozitive në procesin e hapjes, 50% e të anketuarve ndjejnë frikë në të qenit një anëtar i komunitetit LGBT në Kosovë dhe pikërisht 50% pretendojnë të mos kenë frikë. Të intervistuarit janë të ndarë në mes të qenit të frikësuar dhe jo, por kur ju kërkohen më shumë detaje përgjigjet tregojnë se edhe në rastet kur të anketuarit nuk ndjehen të frikësuar kjo rrjedh nga guximi personal, e jo nga mbrojtja ligjore apo siguria e përgjithshme. “Shikoj punët e mija, dhe nuk i mundësoj askujt të di se çfarë unë jam apo atë që bëj unë, prandaj unë nuk do të ndjem të frikësuar rreth orientimit tim seksual”, thotë një person homoseksual.

Në kuadër të anketuarve që nuk kanë frikë, gjysma thotë se kjo është pasi ata nuk bien ndesh me ligjin dhe nuk dëmtojnë personat tjerë në ndonjë mënyrë tjetër, ndërsa gjysma tjetër thjesht nuk japin informacion shpjegues rreth orientimit të tyre seksual. Prandaj, edhe në rastet kur ata pretendojnë të mos kenë frikë, frika është manifestuar në mënyrë indirekte pasi ata nuk janë të hapur për orientimin e tyre seksual. Të përziera brenda frikës dhe frikësimit janë mesazhet e guximit njerëzor ku anëtarët qëndrojnë me krenari në mbrojtje të identitetit të tyre pavarësisht se janë sulmuar fizikisht. “Përkundër asaj që unë kam përjetuar, unë nuk kam frikë sepse ndjehen mirë në lidhje me atë që unë jam,” thotë një pyetësor.

“Dhuna kundër LGBT në komunitet dhe fakti se shteti nuk ofron asnjë mbrojtje”, thotë një i anketuar lidhur me burimin e tij/saj të frikës. Në fakt, kjo deklaratë është përsëritur shumë herë. Kur ju kërkohen shpjegime të hollësishme, homofobia e përhapur (46%) dhe rastet e dhunës ndaj pjesëtarëve të bashkësisë (34%) janë identifikuar si dy burimet kryesore të frikës, dhe përveç kësaj 10 për qind e të intervistuarve kanë frikë nga rritja e grupeve radikale dhe 10 për qind liston mungesën e sigurisë si arsye kryesore për të qenë të frikësuar. Në disa raste, frika është e bazuar në përvojën e mëparshme dhe/ose paranojën se familja do t'i përjashtojë nga trashëgimia.




Figura 5 Burimet e frikës në mesin e të anketuarve

Hulumtimi tregon se forma kryesore e dhunës së drejtuar kundër këtij komuniteti ka qenë në formë të abuzimit verbal (40%) në rrugë të bazuar në pamje - më së shpeshti duke u quajtur “qeder” dhe “bulash”, shprehje nënçmuese për një mashkull homoseksual, “lavire” dhe “të sëmurë mendorë”. Megjithatë, rreth 10% e të anketuarve thanë se kishin qenë të ekspozuar ndaj abuzimit fizik, duke përfshirë përdhunimet, rrahjet, therjet ose të pështyrë në rrugë. “Ka pasur një rast kur një person ka menduar se unë isha duke e shikuar dhe ai erdhi, më ra shuplakë dhe më tha “mos më shiko peder”, shkruan një i anketuar.

Në një numër të rasteve personat LGBT janë mashtruar të besojnë që njerëzit me të cilët bisedojnë janë gjithashtu LGBT dhe pastaj janë sulmuar, dhunuar dhe grabitur. “Unë isha me një mik në një vend miqësor për homoseksualët dhe katër persona e prezantuan veten të jenë homoseksual. Kur ishim vetëm, ata kërkuan paratë dhe telefonat tonë. Pasi që nuk i kishim, ata nxorën thikat e tyre. Unë u godita me thikë në këmbë dhe miku im në kokë. Ne kurrë nuk shkuam në polici, dhe u vetë shëruam.” Një tjetër histori tregon për një vepër të rëndë seksuale të kombinuar me largim nga familja, “Në fillim të vitit 2013 kisha takuar një person i cili e paraqiti veten të jetë homoseksual dhe u pajtuam që të takohemi. Në takimin tonë ishin 4 persona të cilët më thanë se ata nuk ishin homoseksual, por se ata ngritin kurthe të ngjashme për homoseksualët. Ata morën telefonin tim, portofolin, xhakëtën, pantallonat – unë mbeta në të brendshmet. Tre prej tyre u larguan dhe njëri më detyroi në marrëdhënie seksuale, edhe pse unë nuk e dija këtë. Unë e raportova rastin në polici dhe shkova në shtëpi, ku u detyrova të tregoj familjes sime se isha homoseksual. Babai im u zemërua - ai bërtiti dhe më ra shuplakë. Pas dy javësh, situata u qetësua.”

Të ballafaquar me abuzim dhe nganjëherë duke jetuar në frikë, anëtarët e komunitetit LGBT gjithashtu mendojnë se çështjet e tyre gjerësisht janë shpërfillur nga media (65%), dhe si e tillë hapësira e tyre publike është rreptësisht e ngushtuar. Nga ana tjetër, vetëm

rreth 33 për qind të zyrtarëve të drejtave të njeriut janë të mendimit se trajtimi i çështjeve të LGBT nga mediat është i dobët.




Figura 6 Vlerësimi i trajtimit medial të çështjeve LGBT nga komuniteti LGBT

## Vetëdijesimi dhe Mbrojtja

Edhe pse korniza ligjore e Kosovës ofron mbrojtje të gjerë për personat LGBT, hulumtimi ynë tregon se komuniteti nuk është i informuar sa duhet për mbrojtjen ligjore në dispozicion dhe mënyrat e kësaj mbrojtjeje. Shumica e të anketuarve (48.9%) thanë se nuk ishin në dijeni nëse ligjet në Kosovë ofrojnë mbrojtje për pakicat seksuale. Rreth 40% e të anketuarve ishin në dijeni për Ligjin kundër diskriminimit dhe një i anketuar mendonte se ekziston një ligj i veçantë për sigurimin e mbrojtjes ligjore për pakicat seksuale.




Figura 8 Njohuria e përgjithshme në lidhje me mbrojtjen ligjore të komunitetit LGBT

Kur jemi të njohur për kanalet ku ndihma dhe mbrojtja mund të kërkohet, anëtarët e komunitetit janë më së miri të informuar në lidhje me mbështetjen në dispozicion nga organizatat e shoqërisë civile (82%), pasuar nga policia (76%). Informacioni mbi mbrojtjen dhe mbështetjen në dispozicion kryesisht përhapet me bisedë (53%), pra nga

një anëtar i komunitetit tek një tjetër, ose vjen nga organizatat joqeveritare. Të anketuarit ndihen më të qetë për t'iu drejtuar organizatave jo-qeveritare (90%) dhe policisë (61%) për të kërkuar mbrojtje si anëtarë të një pakice seksuale. Ndjenja e të qenit të marginalizuar dhe në rrezik, e përshkon të gjithë komunitetin, gjë që shpjegon besimin e lartë në organizatat jo-qeveritare. Një shpjegim pse personat LGBT të anketuar kanë më shumë gjasa t'i drejtohen policisë se sa institucioneve tjera mund të jetë për shkak të rrezikshmërisë së sulmeve me të cilat ata ballafaqohen. Përveç kësaj, shifra e lartë ka më shumë gjasa që të korrespondojë me bindjen e përgjithshme se në qoftë ndodh një sulm duhet të kontaktohet policia sesa për mbrojtje të veçantë të dhënë nga policia për komunitetin LGBT. Këto të gjetura sugjerojnë se duhet të ketë mbështetje të vazhdueshme për sektorin e shoqërisë civile, si një shtyllë e rëndësishme për ndërgjegjësimin dhe mbështetjen psiko-sociale. Megjithatë, është shqetësuese që personat LGBT të cilët nuk janë pjesë e rrjetit janë në rrezik të lënies në errësirë informative lidhur me shërbimet ekzistuese dhe burimet e mundshme të asistencës.




Figura 9 Institucionet / organizata ku personat LGBT drejtohen për mbrojtje dhe përkrahje

## Sfera publike

Në hapësirën publike anëtarët e komunitetit LGBT në Kosovë pretendojnë se ata janë të mbrojtur nga abuzimi vetëm nëse ata nuk janë të hapur për seksualitetin e tyre ose nuk e shfaqin tipare të cilat mund të lidhen me atë që perceptohen si tipare homoseksuale - disa prej të cilave përfshijnë sjellje mashkullore/femërore. Megjithatë, edhe kur këto raste ndodhin, palët e abuzuara shumë rrallë raportojnë përvojën e tyre në organet kompetente. Ky hulumtim tregon se vetëm 5 raporte janë dorëzuar në polici dhe në dy raste ato janë pasuar me vërejtje të papërshtatshme nga ana e oficerëve të policisë. Dy nga këto raporte kanë të bëjnë me rastin e sulmit kundër Libertas në dhjetor të vitit 2012 dhe nuk është dhënë asnjë informatë në lidhje me çka ka ndodhur në këto raste. Një i anketuar thotë se një herë në stacion të policisë, oficeri i policisë e kishte pyetur atë se kur ishte hera e fundit që ai/ajo ka pasur marrëdhënie seksuale, që ishte përtej qëllimit të hetimit.

Në sistemin e arsimit, forma më e gjithëpranishme e raportuar e abuzimit është abuzimi verbal nga studentët e tjerë (4 raste), në një rast një studentit i është mohuar qasja në arsim dhe në një tjetër rast studentit ishte objekt i urrejtjes nga mësuesi. Një nga të anketuarit raporton se ka qenë i sulmuar dhe i pështyrë, por dy të tjerë përshkruajnë se orientimi i tyre seksual u ka kushtuar atyre miqësi dhe injorim – “pasi u kam thënë miqve të mi se isha lezbike, ata më thanë se kjo ishte e sëmurë dhe jo normale.” Në sistemin shëndetësor, dy të anketuar përshkruajnë se janë ndier të diskriminuar dhe kanë marrë trajtim nën-standarde. Një nga tregimet është shumë shqetësues: në spital, pasi u ankua për dhimbje stomaku, një të anketuar u tha se ai “[ishte] ndoshta shtatzënë pasi që [ai] sigurisht pëlqente meshkujt.”

Në vendin e punës, situata nuk është më e mirë: ka raste kur personave LGBT i janë mohuar avancimet, janë objekt ngacmimi, përballen me vështirësi në gjetjen e punësimit ose janë larguar nga puna në bazë të orientimit të tyre seksual. “Unë kisha vështirësi për të gjetur një punë, mu tha “ne nuk kemi punë për pedera.” Kur kam gjetur një punë, kolegët e mi më ofendonin dhe u ankoheshin eprorëve tanë që unë i kam ngacmuar seksualisht ata. Pronari më largoi mua, me arsytim se duhet të ketë të vërtetë aty pasi që unë isha homoseksual dhe të tjerët flisnin në lidhje me këtë,” shtjellon një prej të anketuarve. Por, abuzime dhe shkelje të tilla flagrante të Ligjit kundër diskriminimit përgjithësisht shukaten, duke ruajtur rendin ekzistues shoqëror dhe dominimin e normave shoqërore mbi ato ligjore.

---

## VI. Zbatimi I ligjit

Forca e shtetit shtrihet aq sa edhe aftësia e tij për të mbrojtur anëtarët e dobët të shoqërisë së tij. Ky hulumentim ka shqyrtuar qëndrimet dhe perceptimet e gjyqtarëve, prokurorëve, policëve dhe policeve, avokatëve dhe zyrtarëve të drejtave të njeriut. Konkluzioni i përgjithshëm që mund të nxirret është se opinioni dhe qëndrimet për çështjen e të drejtave të LGBT janë të ndara dhe se ekziston një mungesë e përgjithshme e informacionit, trajnimit dhe ndërgjegjësimit mbi çështjet që i përkasin këtij komuniteti. Zyrtarët publikë dhe oficerët /oficeret nuk kanë marrë ndonjë trajnim mbi këtë çështje, që mund të jetë një nga shkaqet për mungesën e informimit të tyre dhe si një pengesë në trajtimin e drejtë të rasteve që vijnë nga komuniteti LGBT. Përveç kësaj, ekziston një mospërputhje e konsiderueshme midis numrit të shkeljeve që anëtarët e komunitetit LGBT duket të vuajnë dhe nga ato që janë raportuar, duke shkaktuar që vetëm disa raste përfundojnë në duart e gjyqësorit. Kjo mospërputhje mund t'i atribuohet mungesës së besimit të përgjithshëm në institucionet publike dhe në veçanti si rezultat i disa rasteve të raportuara gjerësisht ku institucionet e shtetit nuk arritën të përmbushin detyrën e tyre<sup>35</sup>. Pjesa tjetër e këtij kapitulli shqyrton qëndrimet e profesioneve të ndryshme.

### Gjyqtarët dhe prokurorët

Në total, 25 intervista gjysmë të strukturuar janë realizuar me gjyqtarë dhe prokurorë, nga të cilat shtatëmbëdhjetë me gjyqtarë dhe tetë me prokurorë. Në mesin e gjyqtarëve, 2 merren ekskluzivisht me rastet civile, 5 me rastet civile dhe penale, 2 me rastet civile, penale dhe administrative dhe 4 vetëm me ato penale. Në mesin e gjyqtarëve, 77% janë mbi 50 vjeç dhe një është në mes të moshës 35 dhe 49. Mostra e prokurorëve përbëhet prej 1 zëvendës kryeprokurori, 6 prokurorëve dhe 1 zëvendësprokurori. Nga mostra e prokurorëve, 1 është në mes të moshës 27 dhe 35, 3 janë mes moshës 36 dhe 49, dhe 4 janë mbi 50. Sa i përket fesë, shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë identifikuar si myslimanë, 76 dhe 87.5 për qind respektivisht. Edhe pse është e vështirë për të nxjerrë konkluzione të përgjithshme duke pasur parasysh madhësinë e vogël të mostrës, disa trendë dalin. Shumica e gjyqtarëve (52.9%) pajtohen se ka një lloj të dhunës kundër komunitetit LGBT në Kosovë, ndërsa 23.5 për qind pretendon se ajo kurrë nuk ndodhë; kjo shifër është dukshëm më e ulët në mesin e prokurorëve, ku vetëm 33 për qind pajtohen se ka dhunë. Ekziston një trend i përgjithshëm pozitiv në lehtësimin e pranimin të rasteve që lidhen me çështjet LGBT nga gjyqtarët, përderisa **asnjë nga prokurorët nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje** (shih Figurën 10). Edhe pse duket se gjyqtarët janë të hapur të merren me rastet e personave LGBT, tre gjyqtarë nuk pajtohen apo nuk pajtohen fuqishëm se është e rëndësishme për të trajtuar rastet lidhur me personat LGBT; numri i njëjtë besojnë se asgjë nuk duhet të bëhet për mbrojtjen më të mirë të drejtave të pakicave seksuale në Kosovë. Në pyetjen e fundit, të gjithë prokurorët kanë refuzuar të përgjigjen. Për më tepër, katër prokurorët mohojnë se ka persona LGBT në rrethin ku ata jetojnë dhe një beson se të drejtat e personave LGBT nuk duhet të jenë të mbrojtura.

---

<sup>35</sup> Constable, Pamela. "Persecuted Gays Seek Refuge in the US." The Washington Post.






Figura 10 Se është e lehtë për ju të merreni me një incident lidhur me LGBT (1- aspak, 10- plotësisht lehtë)

Në mesin e gjyqtarëve, 3 raportojnë se ata kanë pranuar raste të diskriminimit apo dhunës kundër personave LGBT në çështjet e mohimit të qëndrimit, dhunimit dhe dhunës në familje. Është e habitshme se pavarësisht seriozitetit të këtyre krimeve të dyshuara, jo të gjitha nga këto raste janë trajtuar – një gjyqtar raporton se nuk ka adresuar ndonjë rast dhe 2 nuk i kanë trajtuar të gjitha rastet. Një gjyqtar pretendon se arsyeja pse jo të gjitha rastet janë adresuar është se nuk ka gjë të tillë si raste kundër personave LGBT. Megjithatë, duke pasur parasysh se vetëm një pjesë e vogël e incidenteve janë raportuar dhe ato duket se përcjellën pjesërisht, ky sistem stimulon fragmentimin e mëtejshëm dhe vazhdimin e besimit të ulët të komunitetit ndaj institucioneve publike. Pavarësisht nga një ekspozim në përgjithësi i kufizuar ndaj komunitetit LGBT, të dyja grupet e profesionistëve tregojnë një tendencë për hapje ndaj këtij komuniteti. Një qëndrim i tillë bëhet më i qartë në pyetjen se si ata do ta trajtonin një koleg homoseksual: 50% e prokurorëve dhe 47% e gjyqtarëve janë të prirur që këtë t'a marrin me lehtësi.




Figura 11 & 10 Të pasurit e një kolegu LGBT (1- aspak lehtë, 10- plotësisht në lehtësi) : Gjyqtarët dhe Prokurorët

Këto qëndrime reflektohen edhe në pyetjen në lidhje me të drejtat që pjesëtarët e komunitetit LGBT duhet të kenë, ku shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë dakord që ata duhet të kenë të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si gjithë të tjerët dhe se të gjitha raportet që vijnë nga komuniteti LGBT duhet të konsiderohen.

Për të përfunduar, provat e paraqitura më lart sugjerojnë se pavarësisht një mungese të përgjithshme të trajnimit mbi çështjet LGBT, profesionistët gjyqësorë janë në dijeni për të drejtat e njëjta për të gjithë anëtarët e shoqërisë dhe kanë një mirëkuptim se të drejtat e LGBT janë të drejta të njeriut. Tendenca e përgjithshme në qëndrimet kundrejt trajtimit të rasteve është pozitive - rastet duhet të trajtohen. Megjithatë, në praktikë, për arsye të cilat janë përtej qëllimit të këtij raporti, jo të gjitha incidentet që raportohen janë përcjellë dhe autorët nuk janë sjellë para drejtësisë. Edhe nëse këto përfaqësojnë raste të izoluar, ato kontribuojnë më tej në shpërbërjen e marrëdhënies midis shtetit dhe qytetarit.

## Shërbimi dhe Mbrojtja: Policia

Në një përpjekje për të përfshirë të gjitha nivelet e forcave të policisë, ky hulumtim u përqendrua duke kryer intervista gjysmë të strukturuar me një kapiten, toger, majorë, rreshterë dhe një numër të oficerëve: 30 pyetësorë janë shpërndarë në total. Të gjithë policët në mostër ishin myslimanë shqiptarë të Kosovës, nga të cilët rreth 55% nganjëherë praktikojnë fenë. Në krahasim me gjyqtarët dhe prokurorët, policia është më e vetëdijshme për dhunën kundër komunitetit LGBT, ku 60% u pajtuan se abuzimi ndodh ose ndodh herë pas here. Llojet më të përmendura të raporteve janë abuzimi verbal në hapësirat publike apo kërcënimet e shprehura, të cilat kanë qenë kryesisht të trajtuara nga policia (90%). Në të njëjtën kohë, policia tregon tolerancë të lartë në pranimin e një kolegu LGBT, ku mbi 66% e policëve/policeve të intervistuar e vlerësojnë me 5 ose më lartë (në një shkallë 10 pikëshe –ku 10 është me lehtësi të plotë), lehtësinë me të cilën ata do të praninin atë. Qëndrime të ngjashme reflektohen edhe në aspektin e të drejtave dhe mbrojtjes që duhet të ofrohen për komunitetin LGBT, dhe si të trajtohen raportet e incidenteve nga komuniteti LGBT: 70% pajtohen që të njëjtat të drejta duhet të jenë të garantuara për të gjithë qytetarët dhe 77% pajtohen se të gjitha raportet e incidenteve duhet të adresohen. Megjithatë, gati gjysma (46%) e oficerëve të policisë të intervistuar besojnë se këto të drejta janë duke u imponuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe rreth 10 për qind mendojnë se nuk ka nevojë për të marrë të gjitha masat për të siguruar të drejta më të mira për këtë komunitet.

Ndryshe nga institucionet e tjera, disa policë/police raportojnë të jenë trajnuar mbi të drejtat e LGBT nga departamenti ku ata punojnë, pushteti lokal dhe organizata të shoqërisë civile. Përderisa anëtarët e komunitetit LGBT frikohen për sigurinë e tyre dhe përmbahen nga raportimi i incidenteve, të dhëna nga intervistat japin indikacion të kufizuar se pse perceptimi i tillë mbizotëron, por tregojnë se ka hapësirë për përmirësime në aspektin e njohurive dhe vetëdijes në mesin e oficerëve të policisë. Disa nga rezervimet mund të jenë një rezultat i tregimeve të trajtimit të keq të raporteve të incidenteve nga policia, e cila kumbon rëndë në komunitetin LGBT në Kosovë<sup>36</sup>.

<sup>36</sup> Constable, Pamela. "Persecuted Gays Seek Refuge in the US". The Washington Post. July 10, 2007

## Institucionet qeveritare

Një nga rolet e qeverisë është që të krijojë një shoqëri të barabartë dhe të drejtë; kjo nënkupton respektimin e të drejtave të njeriut, tolerancën, lirinë dhe drejtësinë. Roli i qeverisë është për të përmirësuar barazinë dhe zvogëluar diskriminimin për të gjithë, në punë, në jetën publike dhe politike, që është arsyeja pse 59 (me fjalë: pesëdhjetë) pyetësorë u shpërndanë zyrtarëve për të drejtat e njeriut në nivele të ndryshme të qeverisë në nivel të ministrive (20), komuna (32), Zyra për Qeverisje të Mirë (1) dhe institucionit të Avokatit të Popullit (6). Ngjashëm me gjyqësorin dhe policinë, zyrtarët për të drejtat e njeriut kanë pasur ekspozim të kufizuar ndaj çështjeve LGBT, kanë trajtuar një numër shumë të vogël të incidenteve dhe vetëm disa janë trajnuar. Gjatë intervistave, disa zyrtarë bënë të qartë se ata i plotësonin pyetësorët ashtu siç pritej, por se mendimet e tyre personale ndryshonin, duke shprehur drejtpërdrejtë opinione diskriminuese rreth personave LGBT. Ata janë të hapur për të pranuar kolegët LGBT, por në përgjithësi e perceptojnë se kjo çështje është duke u imponuar mbi Kosovën nga bashkësia ndërkombëtare.

Në pyetjet e përgjithshme në lidhje me diskriminimin e pjesëtarëve të komunitetit LGBT, zyrtarët duket të jenë të vetëdijshëm për ekzistimin e dukurisë (49%). Përgjigja më e shpeshtë, megjithatë, është ajo që aludon në mohimin e tërësishëm të këtij grupi - se nuk ka persona LGBT në komunitetin e tyre ose në afërsi. Në institucionet e hulumtuara, janë raportuar vetëm 2 raste, nga të cilat një ka marrë një përgjigje të pjesshme institucionale.




Figura 12 Pranimi i të drejtave dhe kolegut LGBT (1- aspak, 10 – plotësisht lirshëm)

Është e qartë se ka ndërprerje të komunikimit midis anëtarëve të komunitetit LGBT dhe zyrtarëve të drejtave të njeriut. Zyrtarët e paktë që raportojnë angazhimin me komunitetin LGBT dhe shpjegojnë rolin e departamentit të tyre, e bëjnë këtë nëpërmjet takimeve private, forumeve publike, broshurave dhe fletushkave. Tre zyrtarë raportojnë se njësia e tyre ka avokuar në nivel qendror apo lokal për të ndryshuar legjisllacionin në mënyrë që të adresohen të drejtat e LGBT. Në të njëjtën kohë, një zyrtar beson se asgjë nuk duhet të bëhet në mënyrë që të fuqizohen të drejtat e LGBT dhe një tjetër beson se “duke pasur parasysh problemet që ka kjo shoqëri, çështjet LGBT nuk janë fare të vlefshme për tu adresuar.”

Në krahasim me palët tjera të interesuara të përfaqësuara, zyrtarët e drejtave të njeriut raportojnë se njohin më shumë anëtarë të komunitetit LGBT, por kjo mund të jetë si pasojë e numrit të lartë të intervistave që u zhvilluan në Prishtinë dhe me institucione që punojnë direkt me këto komunitete (të tilla si Avokati i Popullit). Derisa të dhënat e përgjithshme tregojnë aspekte më pozitive në mesin e zyrtarëve të drejtave të njeriut, ekzistojnë pikëpamje të cilat shfaqin nevojën për avokim të mëtejshëm mbi çështjet LGBT. Për të ilustruar këtë, kur u pyetën për të vlerësuar mbulimin nga media të çështjeve të LGBT, gati gjysma e zyrtarëve të intervistuar e perceptojnë që ai është në mes të shkëlqyeshëm dhe të mjaftueshme, që përshkruan një mospërputhje në perceptimin e vetë komunitetit dhe zyrtarëve. Për më tepër, një i anketuar beson se nuk ka komunitet LGBT në Kosovë. Edhe në qoftë se kjo pikëpamje në vetvete nuk është e rëndësishme në aspektin statistikor, është e rëndësishme të kemi parasysh se kjo është pikëpamje e një zyrtari që merret me të drejtat e njeriut.




Figura 7 Vlerësimi i trajtimit nga media të çështjeve të LGBT sipas zyrtarëve të drejtave të njeriut

## VII. Kërkimi i ndihmës mjekësore

Të anketuarit në mesin e profesionit mjekësor janë përzgjedhur me kujdes nga degët mjekësore që janë më relevante për shëndetin dhe mirëqenien e anëtarëve të komunitetit LGBT. Për këtë qëllim, pyetësorët u shpërndanë për praktikuesit në mjekësinë familjare (42%), infektive (8%), urologji (10%), gjinekologji (14.6%), psikologji (2.2%), psikiatri (9%), dermatologji (7.9 %) dhe stomatologji (1%). Numri mbizotërues i profesionistëve mjekësore (90%) besojnë se personave LGBT duhet t'i jepet trajtim i barabartë. Megjithatë, edhe në qoftë se shifrat duken optimiste, hulumtuesit janë përballur me vështirësi të mëdha në inkurajimin e profesionistëve mjekësorë për të plotësuar pyetësorët. Sfidat në gjetjen e profesionistëve mjekësorë të gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve ndoshta është e lidhur me rolin dhe përgjegjësinë (ose mungesën e tyre) që profesionistët mjekësorë shohin në sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë pacientët, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual.

Një total prej 89 pyetësorëve janë shpërndarë për profesionistët mjekësorë në një përpjekje për të vlerësuar të kuptuarit e tyre themelor dhe qëndrimet ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT. Shumica e të anketuarve (60.7 %) ishin në mes të moshës 36-49, ku 11.2 % kanë qenë në moshë 27 deri 35 vjet dhe 28% mbi 50 vjet. Në këtë mostër 86.5% janë mjekë, 9% janë infermierë dhe një total prej 4% janë terapistë, asistentë mjekësore dhe të tjerët. Numri mbizotërues i profesionistëve të intervistuar (63%) punojnë në spital publik, 36% punojnë në klinikat publike, ndërsa vetëm 1% e profesionistëve të intervistuar gjatë këtij hulumtimi kanë punuar në një spital privat. Gjithashtu, vetëm 1% e të anketuarve i takojnë komunitetit jo-shumicë, pjesa tjetër janë shqiptarë të Kosovës.

Kur diskutojnë dhunën dhe diskriminimin, gjysma e të anketuarve mjekësore pajtohen se kjo ndodhë ndonjëherë apo në disa raste, ku vetëm 7.3% pajtohen se kjo ndodhë gjatë gjithë kohës, ndërsa 11% besojnë se ajo kurrë nuk ndodhë. 30% e të anketuarve janë përgjigjur në këtë pyetje duke thënë se në afërsi të tyre nuk ka persona të LGBT.

Më shumë se në profesione të tjera të intervistuar për qëllimin e këtij raporti, 21.4% e intervistave mjekësore pohojnë se kanë pasur një pacient që ka vetë-identifikuar vetën si lezbike, homoseksual, biseksual apo transgjinator. Kur u pyetën nëse ata kanë pasur pacientë të cilët ata i kanë perceptuar të jenë lezbike, homoseksual, biseksual apo transgjinator - 37% e të anketuarve u përgjigjen pozitivisht. Nga 26 përgjigje më të hollësishme nga ato që janë përgjigjur pozitivisht, 16 pretendojnë se kanë përcaktuar se personi ishte lezbike, homoseksual, biseksual apo transgjinator në bazë të sjelljes ose dukjes. Tre të anketuar thanë se atyre i është thënë kështu nga pacientët e tyre, dhe një bazuar në ekzaminim psikologjik. Një i anketuar pretendon të jetë në gjendje të përcaktojë seksualitetin bazuar në testimin e hormoneve dhe një tjetër i anketuar përcakton seksualitetin e pacientëve të tij bazuar në statusin e tyre civil – “(a) i/jo i plotësuar të gjitha kushtet për t'u martuar, por nuk është.”

Përveç njërit, të gjithë profesionist mjekësor të intervistuar për këtë hulumtim kanë thënë se ata nuk kanë refuzuar trajtim për një person të bazuar në besimin se ata ishin një anëtar i komunitetit LGBT.




Figura 10 Lehtësia me të cilën një pacient që i përket komunitetit LGBT trajtohet (1- aspak, 10 – lehtësi e plotë)

Numri i ankesave për dëmin psikologjik dhe fizik të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në polici, i korrespondon më shumë ose më pak me numrin e trajtimeve të dhëna nga mostra mjekësore të anketuarve - gjithsejtë 7. Nga shtatë pacientë të pranuar, dy janë raportuar të kenë ardhur me lëndime fizike dhe shenjat e dhunimit, dy ankesa të raportuara në lidhje me gjuhën e urrejtjes, dy kanë raportuar se janë ngacmuar, dhe një i është drejtuar profesionistëve mjekësorë të kërkojë ndihmë pasi ai/ajo ishte përzënë nga shtëpia e familjes.

Shoqata Amerikane e Psikiatrisë e hoqi homoseksualitetin nga Manuali zyrtar Diagnostifikues dhe Statistikor i Çrregullimeve Mendore në vitin 1973, pas konsultimeve me ekspertë dhe rishikimit të literaturës shkencore<sup>37</sup>.

Shoqata Amerikane e Psikologjisë në janar 1975 miratoi një rezolutë duke deklaruar se homoseksualiteti në vetvete nuk nënkupton një dëmtim në vlerësim, stabilitet, besueshmëri, apo aftësitë e përgjithshme shoqërore dhe profesionale dhe i bëri thirrje të gjithë profesionistëve të shëndetit mendor për të marrë rolin udhëheqës në largimin e stigmës së sëmundjes mendore e cila ka qenë e lidhur me orientime homoseksuale<sup>38</sup>.

<sup>37</sup> Association of Gay and Lesbian Psychiatrists. [http://www.aglp.org/gap/1\\_history/](http://www.aglp.org/gap/1_history/)

<sup>38</sup> Shoqata Amerikane e Psikologjisë. <http://www.apa.org/about/policy/discrimination.pdf>

Në mostrën tonë, në pyetjen nëse ata konsiderojnë homoseksualitetin të jetë një sëmundje apo një çrregullim, rreth 94% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen dhe vetëm 6% janë përgjigjur negativisht. Në kombinim me dy pyetjet e mëposhtme duke hetuar burimin e këtyre besimeve dhe trajtimeve të përcaktuara për personat LGBT, një i intervistuar tha se ky besim është i bazuar në literaturën shkencore dhe dy të anketuar thanë se ata do të rekomandojnë trajtimin psikiatrik apo psikologjik, dhe pjesa tjetër refuzoi të përgjigjen. Për më tepër, një prej personave të intervistuar LGBT raporton se ka vizituar një psikiatër për shkak të problemeve të gjumit dhe kur ka zbuluar se ajo ishte lezbike, psikiatri argumentoi se kjo ishte burimi i problemeve të saj. Këto dëshmi janë shqetësuese, madje edhe nëse ato janë raste të izoluar.

### Qëndrimet ndaj HIV-it dhe komunitetit LGBT

Globalisht, meshkujt homoseksual ose biseksual janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga epidemia e HIV-it. Në kryeqytetet evropiane, të rinjtë homoseksual kanë një rrezik jetësor të bëhen HIV - pozitiv që përputhet me atë të meshkujve të rinj në Afrikën e Jugut, që është zona më e prekur nga HIV në botë<sup>39</sup>. Për krahasim, në SHBA më shumë se 60% të infeksioneve të reja dhe gjysma e të gjithë amerikanëve që jetojnë me HIV i përkasin këtij grupi<sup>40</sup>. Të dhënat e krahasueshme nuk janë në dispozicion për Kosovën, për shkak të mungesës së raportimit, informimit të besueshëm dhe frikës së përgjithshme mbizotëruese brenda komunitetit LGBT<sup>41</sup>. Të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, në mes të 1986, kur rasti i parë u regjistrua, deri në vitin 2012, tregojnë se ka pasur 87 raste të raportuara të HIV dhe AIDS, prej të cilëve 47 janë me AIDS dhe 40 me infeksionin HIV. Sipas gjinisë dhe demografisë, nga personat e infektuar 69% kanë qenë meshkuj dhe 37% i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç<sup>42</sup>. Deri në vitin 2012, janë regjistruar 39 vdekje nga infeksioni.

Profesionistët mjekësorë kosovar, kur pyeten në lidhje me HIV dhe orientimin seksual, shfaqin një sërë të besimeve që janë paragjyquese ndaj këtij komuniteti. Ndër të anketuarit, 70% përgjigjen pozitivisht në qoftë se anëtarët e LGBT-së duhet të jenë të detyruar për t'u testuar për HIV dhe 79% në lidhje me të tjera SST. Për më tepër, 23% e profesionistëve mjekësor pohojnë se kanë kërkuar që një person që është vetë-identifikuar ose për të cilin ata dyshuan të jetë lezbike, homoseksual, biseksualë ose transgjinator, t'i nënshtrohet testimit HIV. Numri mbizotërues i profesionistëve (80%) tregojnë gatishmëri për të siguruar trajtim anëtarit të komunitetit LGBT, edhe nëse ky i fundit nuk ka kaluar testimin e HIV-it, edhe pse një numër i konsiderueshëm -20% refuzojnë të përgjigjen ose do të refuzonin trajtimin (14.6%).

<sup>39</sup> UNAIDS. Right to Health, Right to Life: HIV and human rights in Europe. May 29, 2013. URL: <http://www.unaids.org/en/resources/presscentre/featurestories/2013/may/20130529euhiv/>

<sup>40</sup> Mermin, Jonathan. "HIV Impact on Gay and Bisexual Men: The 4th Decade." September 27, 2013. URL: <http://blog.aids.gov/2013/09/hiv-impact-on-gay-and-bisexual-men-the-4th-decade.html>

<sup>41</sup> "Knowledge, Attitudes, Practices and Behavior Study on HIV/AIDS with Young People in Kosovo." United Nations Kosovo Team. 2008 URL: [http://www.unicef.org/kosovo/KAPB\\_HIV\\_AIDS\\_Eng\\_Final.pdf](http://www.unicef.org/kosovo/KAPB_HIV_AIDS_Eng_Final.pdf)

<sup>42</sup> Ibid.

---

Duke pasur një numër mbizotërues të profesionistëve mjekësor që kërkojnë testin e HIV nga një person LGBT, pavarësisht nga simptomat, demonstroi se si paragjykimi është përhapur dhe përbën një pushtim të privatësisë.

Pavarësisht rezultateve inkurajuese të përgjithshme lidhur me gatishmërinë për të siguruar trajtim të pacientëve LGBT cilët nuk i janë nënshtruar testimit, fakti se një në shtatë profesionistë mjekësorë do të refuzonin trajtimin e një pacienti paraqet rrezikshmëri shëndetësore për komunitetin LGBT. Në profesionin mjekësor, si në të tjerët që i nënshtrohen këtij hulumtimi, shërbimet themelore janë në rrezik për t'u ndaluar për anëtarët e shoqërisë që i nënshtrohen stereotipit dhe paragjykimit.



## VIII. Përfundim

Në rrugën e Kosovës drejt evropianizimit dhe konsolidimit demokratik, mbrojtja e të drejtave të pakicave seksuale është duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme. Kushtezimi i BE-së në fushën e të drejtave të njeriut ka qenë më rreptë i aplikuar kundrejt Kroacisë, ndjekur nga plane konkrete të veprimit, se sa ndaj vendeve të pranuar në zgjerimin e vitit 2004 dhe 2007. Këto parime dhe kushtet po monitorohen me kujdes për Kosovën dhe vendet e tjera në regjion që aspirojnë anëtarësimin në BE. Në praktikë, kushtet e jetesës dhe të punës për komunitetin LGBT do të duhet të përmirësohen, në përputhje me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të duhur.

Komuniteti LGBT në Kosovë dhe organizatat e pakta funksionale janë shtylla kryesore e mbështetjes psiko- sociale për personat LGBT, ndërkohë që normat tradicionale shoqërore vazhdojnë të luajnë një rol kyç në formësimin e jetës së personave LGBT. Në fakt, 45 për qind e të intervistuarve janë të frikësuar nga hapja drejt anëtarëve të familjeve të tyre në lidhje me orientimin e tyre seksual. “Ndoshta prindërit e mi edhe e dinë, por ne nuk flasim për këtë”, thotë një i anketuar, “ata shpesh më bëjnë me dije se në qoftë se unë do të isha homoseksual unë do të humbja mbështetjen e tyre.” Dëshmi të ngjashme janë të shpeshta – një i tjetër i anketuar thotë se kjo është rezultat i “injurancës së familjes së tij/saj për të pranuar dikë që është LGBT. Shumë faktorë janë të përfshirë këtu, sidomos, arsimimi, kultura, tradita dhe fakti që familja ime do të injorohet nga rrethi.” Gama e vlerave tradicionale shtrihet për të përfshirë shërbimet publike dhe çon në një shpërbërje të lidhjes midis qytetarëve dhe shtetit, pasi që personat LGBT hezitojnë të raportojnë abuzimet dhe autorët e krimin nuk sillen para drejtësisë. Për më tepër, diskriminimi në shërbimet publike mund të çojë në mospërputhje në rezultatet e arsimimit dhe kujdesit shëndetësor, duke rezultuar në izolimin e mëtejshëm të këtij grupi.

Në fushën e zbatimit të ligjit, oficerët e policisë dhe zyrtarët e të drejtave të njeriut kanë pasur maksimumin e ekspozimit ndaj çështjeve të komunitetit LGBT, ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët më pak. Duket se ekziston një marrëveshje e përgjithshme, me ndryshim të vogël, që rastet e komunitetit LGBT duhet të trajtohen dhe një tendencë drejt pranimit të kolegëve potencialisht LGBT. Zbatuesit e ligjit kanë pasur qasje të kufizuar në trajnimet në këtë fushë dhe shumica pajtohen se këto do të ishin të dobishme në punën e tyre. Megjithatë, opinioni është i ndarë mbi atë nëse të drejtat e komunitetit LGBT janë duke u imponuar mbi Kosovën nga bashkësia ndërkombëtare: 30 për qind e gjykatësve dhe 43 për qind e policëve besojnë se kjo qëndron. Edhe pse tendenca është pozitive, nevoja për trajnime të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit është e nevojshme. Kur kthehemi te profesionistët mjekësorë, anëtarët LGBT mund të presin të marrin trajtim të barabartë, me disa përjashtime. Profesionistët mjekësorë janë treguar nivele të larta të tolerancës si në trajtimin e pacientëve nga LGBT dhe pranimit të një kolegu LGBT. Megjithatë, gjithsej janë tre raste, ku profesionistët mjekësorë kanë pranuar që kanë mohuar trajtim ose i kanë referuar një mjeku tjetër pacientët për të cilët ata besonin

---

se jenë persona LGBT. Edhe në qoftë se ky numër është i ulët, sjellja e tillë profesionale është shkelje e ligjeve të Republikës së Kosovës, të cilat garantojnë ofrimin e barabartë të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ekzistenca dhe shtrirja e stereotipit bëhet edhe më e qartë kur 15% e profesionistëve mjekësorë pretendojnë të refuzojnë trajtimin e një anëtari të LGBT, nëse ai/ajo nuk e ka testimin për HIV, dhe 95 për qind refuzojnë të përgjigjen në pyetjen nëse ata mendojnë se të jesh homoseksual përbën një sëmundje mendore. Këto shifra tregojnë se në mënyrë të ngjashme me profesionet e tjera të intervistuar, profesionistët mjekësorë janë në një farë shkalle të vetëdijshëm për mënyrën e “drejtë” për t’iu përgjigjur pyetjeve – ku “drejtë” nënkupton atë që pritet nga organizatat kërkimore - por kur hulumtimi shkon më thellë, përgjigjet japin njohuri për bindjet e vërteta të cilat janë të karakterizuara nga paragjykimet. Në praktikë, kjo mund të reflektojë në mënyrën se si rastet dhe pacientët nga komuniteti LGBT janë trajtuar. Për të përmbledhur, anëtarët LGBT janë të ekspozuar në nivelet mbi mesatare të diskriminimit në sferën publike dhe bartësit e detyrave nuk janë në gjendje për të zbatuar të drejtat e parashikuara në kornizën ligjore. Edhe kur mjetet juridike janë në dispozicion, mungesa e trajnimit të organeve të zbatimit të ligjit të kombinuara me besim të ulët në agjencitë e zbatimit të ligjit nga ana e personave LGBT, i bëjnë këto mjete juridike të paefektshme. Ofrimi i shërbimeve publike nuk është plotësisht i paanshëm dhe jo-diskriminues, duke lënë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Duke krahasuar dhe ballafaquar të dhënat nga akterë të ndryshëm, bëhet e qartë se arsyeja prapa raportimit të kufizuar të abuzimit nga anëtarët e komunitetit LGBT buron më shumë nga perceptimet se sa nga vetë përvoja. Hapësira për përmirësim ekziston si në fuqizimin e personave LGBT që të dinë të drejtat e tyre, dhe mbështetjen institucioneve publike dhe sektorit të shoqërisë civile në fuqizimin e dialogut me komunitetin LGBT.

## IX. Rekomandimet

Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit të këtij raporti, rekomandimet e mëposhtme kryesore duhet të merren parasysh për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit për komunitetin LGBT.

### Institucionet publike

1. Mbështetja e hapur nga politikanët, si në qeveri dhe në opozitë, dhe anëtarët e respektuar të shoqërisë për promovimin e të drejtave të LGBT. Një dialog i vazhdueshëm mes partive politike, universitetit, medias dhe aktivistëve të shoqërisë civile është i nevojshëm për të formësuar opinionin publik.
2. Zhvillimi i një Plani Kombëtar të Veprimit për të promovuar respektin për personat LGBT dhe integrimin e çështjeve LGBT në fushata më të gjëra avokuese për të drejtat e njeriut. Këto përpjekje duhet të zhvillohen në sinergji në mes të Qeverisë, Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile.
3. Trajnimet për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë mbi çështjet dhe të drejtat e LGBT, duke mundësuar që ata të jenë të vetëdijshëm për motivet e identitetit gjinor apo orientimit seksual në krimet e raportuara. Për më tepër, trajnimi i posaçëm duhet t'iu jepet oficerëve të policisë në mbështetjen e viktimave.
4. Trajnime mjekësore, kurrikula dhe politikat shëndetësore duhet të përditësohen dhe të marrin parasysh nevojat e personave LGBT. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet adresimit të mbizotërimit të stereotipit në trajnim mjekësor, që ndoshta vjen nga tekstet shkollore të vjetruara.
5. Aktivitete të ndërgjegjësimit të cilat do të informojnë personat LGBT se ku dhe se si ata mund t'iu qasen strukturave dhe të mësojnë procedurat për të raportuar diskriminimin, krimet e urrejtjes dhe fjalorin e urrejtjes.

### Shoqëria Civile

6. Krijimi i një rrjeti të organizatave të drejtave të njeriut që avokojnë për të drejtat e LGBT dhe ofrojnë mbështetje dhe këshilla për personat LGBT në tërë Kosovën. Për të arritur efektin e dëshiruar, fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit duhet të jenë të qëndrueshme dhe të zhvillohen në tërë Kosovën, që kërkon një rrjet të gjerë të organizatave. Një rrjet më i madh do të sigurojë qasje më të lehtë tek personat LGBT që kërkojnë ndihmë.
7. Përcjellja e kujdesshme të rasteve kundër-diskriminimit në bazë të orientimit seksual që janë raportuar dhe/ose janë duke u ndjekur penalisht. Shoqëria civile mund të informojë publikun, duke siguruar të dhëna statistikore për numrin e rasteve të raportuara te autoritetet publike, llojet e veprave penale dhe dënimet të cilat janë shqiptuar.

- 
8. Sigurimi i mbështetjes së universitetit, medias, kulturës dhe figurave publike nga sfera të ndryshme të jetës publike për promovimin aktiv dhe vazhdimin e debatit mbi të drejtat dhe liritë e LGBT.

**Komuniteti Ndërkombëtar/Donatorët:**

9. Prioritizimi i çështjes LGBT, duke rritur mbështetjen publikisht dhe presioni politik mbi institucionet publike, për qasje koherente në adresimin e raporteve që vijnë nga personat LGBT, ose në lidhje me çështjet LGBT.
10. Ndhima e vazhdueshme dhe e qëndrueshme për organizata që punojnë drejtpërdrejtë në çështjet LGBT, si dhe mbështetja e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me të drejtat e njeriut dhe mediat për të sensibilizuar opinionin publik.

